

VENDIM
Nr. 673, datë 15.10.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR “BY-PASS PLEPA - KAVAJË - RROGOZHINË, RRUGËT
DYTËSORE NGA ANA E HEKURUDHËS (LOTI 1 DHE 2)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-pass Plepa - Kavajë - Rrogozhinë, rrugët dytësore nga ana e hekurudhës (loti 1 dhe 2)”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë “arë”, “truall” dhe “ullishte”, me sipërfaqe 886 (tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë) m², me vlerë të përgjithshme të shpronësimit, gjithsej, 796 514 (shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e katërmëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 796 514 (shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e katërmëdhjetë) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2015, zëri “Detyrimet e prapambetura”.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 3, 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
SEKTORI SHPRONËSIMEVE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Lista e pasurive që shpronësohen nga ndërtimi i segmentit rrugor “By pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë”
Rrugët dytësore nga ana e hekurudhës (loti 1 dhe 2)

Nr.	Pronari			Z.K	Nr /pas	Sip. m ²	Lloji i pasurisë	Çmimi	Vlera	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	Shpetim		Dedëj	3385	245/5	58	Are+tr	899	52142	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Fiqiret		Dedëj	3385	245/7	85	Are	899	76415	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Kadri		Dedëj	3385	245/8	116	Are+tr	899	104284	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Rustem		Dedëj	3385	245/14	131	Are+tr	899	117769	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Avdulla		Dedëj	3385	245/15	102	Are+tr	899	91698	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Riza		Dedëj	3385	245/16	100	Are+tr	899	89900	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Silvana		Dedëj	3385	245/17	63	Are	899	56637	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Shpetim		Dedëj	3385	245/18	52	Are	899	46748	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Petrit		Dedëj	3385	245/67	49	Are	899	44051	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Ferit		Blloshmi	3385	458/37	92	ullishte	899	82708	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Muhamet		Hersi	3385	458/39	38	ullishte	899	34162	Konfirmuar nga ZVRPP
	SHUMA					886			796514	